

20212884516

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT SA I PËRKET
DETYRIMEVE NGA MARRËVESHJA FINANCIARE E DESTINUAR PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT “INTERKONEKTOR I PËRÇIMIT TË GAZIT
NATYROR GREQI – MAQEDONIA E VERIUT, PJESA E MAQEDONISË SË VERIUT”
QË DO TË NËNSHKRUHET NDËRMJET BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE
DHE SHOQËRISË AKSIONARE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE
ENERGJETIKE – RESURSE ENERGJETIKE NACIONALLE SHKUP, NË PRONËSI TË
SHTETIT**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes financiare e destinuar për financimin e projektit “Interkonektor i përçimit të gazit natyror Greqi – Maqedonia e Veriut”, pjesa e Maqedonisë së Veriut, që do të nënshkruhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për Kryerjen e Veprimtarive Energjetike – Resurse Energjetike Nacionale Shkup, në pronësi të shtetit, me vlerë prej 28.900.000 eurove, nëse Shoqata Aksionare për Kryerjen e Veprimtarive Energjetike – Resurse Energjetike Nacionale Shkup, në pronësi të shtetit, nuk i përmbush dhe nuk i servison detyrimet e Marrëveshjes financiare.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë përcaktohen me Marrëveshjen financiare në nenin 1 të këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për Kryerjen e Veprimtarive Energjetike – Resurse Energjetike Nacionale Shkup, në pronësi të shtetit, për financimin e projektit “Interkonektor i përçimit të gazit natyror Greqi – Maqedonia e Veriut”, pjesa e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që dalin nga Marrëveshja financiare në nenin 1 të këtij ligji, si dhe servisimi i huasë do të kryhen nga Shoqata Aksionare për Kryerjen e Veprimtarive Energjetike – Resurse Energjetike Nacionale Shkup, në pronësi të shtetit, nga të ardhurat e realizuara, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen financiare në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji, mund të tërhiqet më së shumti në 10 transhe. Vlera minimale e transhesë është me vlerë prej 3.000.000 eurove.

Afati për pagesën e çdo transhe të huas, mund të jetë prej katër deri më njëzet e pesë vjet, nga data e tërheqjes së transhesë, me grejs periudhë të përfshirë që mund të jetë nga 30 ditë deri më pesë vjet nga data e tërheqjes së transhesë.

Në kuadër të limiteve të lartpërmendura, për çdo transhe veçmas përcaktohen kushte konkrete, duke e përfshirë edhe normën e interesit.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja financiare në nenin 1 të këtij ligji dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Shoqëria Aksionare për Kryerjen e Veprimtarive Energjetike – Resurse Energjetike Nacionale Shkup, në pronësi të shtetit, do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.